REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI BASENIT UJOR SHKUMBIN**

# VENDIM

ZYRA E ADMINISTRIMIT TE BASENIT UJOR SHKUMBIN-SEMAN
Nr. 898 Prot.
Datë,më 27.12.2024

**Nr.33, datë 19.12.2024**

**PËR**

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIM TË LEJES, NGA SHOQËRIA "C & S CONSTRUCTION" SH.P.K TEK SHOQËRIA "C & S ENERGY" SH.P.K .**

Në mbështetje të shkronjës "b" të pikës 2, të nenit 41, të ligjit nr.111/2012, "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, "*Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim për dhënien me koncension të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujrave të pëdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre*", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e kërkesës për transferimin e lejes Nr.VI/6, datë 17.8.2010 "Leje për përdorim rezerve ujore për ndërtimin e H/C "Rapun 3", "Rapun 3A", "Rapun 4", përroi Rrapun, Zalli Qarrishtë. Librazhd.", dhënë me vendim VI/6 datë 17.2.2010 nga Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin-Devoll

   **Nga shoqëria "C & S CONSTRUCTION" sh.p.k me Nipt K34107805J tek shoqëria "C & S ENERGY" sh.p.k me Nipt K92402005Q,**

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

   **HEC Rrapun 3**
   Vendndodhja e veprës së marrjes 1/ burimi ujor Lumi i Qarrishtës
   - X= 525422.7; Y= 4564906.2; Z=249.7 m.m.n.d. (KRGJSH)
   - Prurja llogaritëse: 8 $m^3/s$
   - Prurja mesatare vjetore: 5.6 $m^3/s$
   - Prurja ekologjike: 0.6 $m^3/s$

Vendndodhja e godinës së Centralit
- X= 525049.4; Y= 4561921.6; Z=233 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja që shkarkohet: 8 $m^3/s$

**HEC Rrapun 4**

Vendndodhja e veprës së marrjes 1/ burimi ujor Lumi Shmil dhe Lunik
- X= 524982.2; Y= 4565331.3; Z=2878 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 19 $m^3/s$
- Prurja mesatare vjetore: 9.81 $m^3/s$
- Prurja ekologjike: 1.4 $m^3/s$

Vendndodhja e godinës së Centralit
- X= 525049.4; Y= 4561921.6; Z=233 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja që shkarkohet: 19 $m^3/s$

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit te subjektit te interesuar.

**KRYETARI I KBU SHKUMBIN**

**ALI MYSLIU**